



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:010818

Datë: 20.05.2021

Numri i dokumentit: 01796464

C.nr. 65/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Kaltrinë Haliti, në çështjen juridike të paditëses Sh.M nga Gjilani, të cilin e përfaqëson me autorizim Fadil Sinanaj, avokat nga Gjilani kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i saj Sevdail Ahmeti jurist nga Gjilani, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar, vlera e objektit të kontestit 446.70 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të mbajtur me datë 18.05.2021, merr këtë;

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar me ligj, kërkesëpadia e paditëses Sh. M nga Gjilani e ushtruar kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm në Gjilan dhe **DETYROHET** e paditura, që paditëses, t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 446.70 €, në emër të një page për shpërblim jubilar, për mbi 10 vite përvojë të punës tek e paditura, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

II. **Obligohet** e paditura Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 199 €, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit së saj me autorizim, në këtë gjykatë ka ushtruar padi ndaj të paditurës me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditëses, t'ia paguaj shumën në lartësi prej 446,70 €, në emër të shpërblimit jubilar në vlerë të një page mujore, me kamat 8% që nga dita e paraqitjes së kësaj padie e deri në pagesën definitive si dhe të ia kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore edhe atë 20€ për taksë gjyqësore për paraqitje të padisë dhe 104 € për përpilim të padisë, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas pranimit të padisë duke vepruar konform nenit 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur ia ka dërguar aktvendimin për përgjegje në padi. Me të cilin e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi.

E paditura përmes përgjigjes në padi të dorëzuar në këtë gjykatë me dt. 09.03.2021 e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se paditësja e ka bazuar padinë në Kontratën Kolektive Sektoriale në nenin 17 të kësaj kontrate duke theksuar se Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, në cilësinë e autoritetit më të lartë menaxhues në Sektorin e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë të Kosovës, në cilësinë e përfaqësuesve të puntorëve shëndetësorë, kanë lidhur Kontratën Kolektive Sektoriale me dt. 11.06.2018 e cila i obligon Institucionet Shëndetësore që ta zbatojnë këtë por që paraprakishtë me rastin e aprovimit të buxhetit të Kosovës për këtë sektor të sigurohen mjete financiare e që si rrjedhojë e kësaj Spitali i Përgjithshëm në Gjilan është i varur drejtpërdrejtë nga Ministria e financave e që për këtë kategori nuk janë siguruar fondet e mjaftueshme për tu kompenzuar, por që Ministria e shëndetësisë u ka premtuar se pas rishikimit të buxhetit do të ndahej një pjesë e mjeteve pikërishtë për implementim të kësaj kontrate, por një gjë e tillë nuk është realizuar.

Në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur me dt. 18.05.2021 përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse i propozuan gjykatës që për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës të kalohet drejtpërdrejtë në seancë kryesore, gjykata e pranoi propozimin e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, ashtu që konform nenit 420.3 të LPK-së, për shkak të ekonomizimit, efikasitetit të procedurës e gjithashtu për shkak të pandërlíkueshmërisë së çështjes kaloi drejtpërdrejtë në shqyrtim kryesor të çështjes.

Në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur me dt. 18.05.2021 përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse i propozuan gjykatës që për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës të kalohet drejtpërdrejtë në seancë kryesore, gjykata e pranoi propozimin e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, ashtu që konform nenit 420.3 të LPK-së, për shkak të ekonomizimit, efikasitetit të procedurës e gjithashtu për shkak të pandërlíkueshmërisë së çështjes kaloi drejtpërdrejtë në shqyrtim kryesor të çështjes.

I autorizuari i paditëses si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses duke kërkuar nga gjykata që të njejtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe të detyrohet e paditura Spitali i Përgjithshëm në Gjilan, që paditëses, t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 446.70 €, në emër të nje page për shpërblim jubilar, për mbi 10 vite përvojë të punës tek e paditura, duke e llogaritur kamatën prej 8% në vit, nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij Aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm ligjor, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës edhe atë 20€ për taksë gjyqësore për paraqitje të padisë, 78€ për përpilim të padisë dhe 101€ për përfaqësim në një seancë.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurës si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare e ka kundërshtuar si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ku ka deklaruar se pas administrimit të provave vërtetohet se kërkesëpadia e paditëses është e pa themelt duke u bazuar në nenin 17.4 ku specifikohet se pundhënësi i fundit është ai që paguan shpërblimin jubilar, andaj i ka propozuar gjykatës që merr aktgjykim refuzues

Gjykata për të vepruar drejtë dhe për ti vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontstimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të protokollit ... e dt..., Vërtetimin e lëshuar nga SPGJ me nr.01-... i dt..., Kërkesën për pagesën e pagave në emër të shpërblimit jubilar të dt.... si dhe Listën e pagave me nr.EM.... e datës 01.05.2018.

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Se paditësja Sh. M ka qenë në marrëdhënie të punës tek e paditura e sistemuar në punët dhe detyrat e punës mami në Repartin e Gjinekologjisë me gjithsej 17 vite përvojë pune (fakte këto të vërtetuara nga Kontrata e punës si dhe nga Vërtetimi i dt. 04.12.2020).

Nga Vërtetimi i lëshuar nga SPGJ me nr.... i dt...., gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan dhe ka përvojë pune 17 vite (që nga data 03.02.2002- 19.09.2019).

Nga Lista e pagave me nr.EM... gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja pagën neto në pozitën të cilën ka punuar e ka pasur 446.70€.

Gjykata në rastin konkret duke vërtetuar faktet se paditësja tek e paditura ka një përvojë për mbi 17 vite, e njëjta pagën e ka pasur në shumë 446.70€ në muaj dhe duke u bazuar në Kontratë Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, konkretisht nenin 4 paragrafi 3 (e cili është në fuqi nga dt.11.06.2018), ku është paraparë *“Përfitues të beneficioneve të cilat dalin nga kjo marrëveshje dhe të cilat bazohen në Ligjin e Punës janë të gjithë punëtorët shëndetësor, ndërsa beneficione që dalin nga marrëveshjet e që nuk janë pjesë e Ligjit të Punës i gëzojnë vetëm anëtarët FSSH-së”*, si dhe nenin 17 pika 3 dhe 4 të po kësaj Kontrate Sektoriale ku është paraparë se *“Punëtorët shëndetësorë, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë për 10 vjet të përvojës së punës në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij, për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore në vlerë të dy pagave mujore të tij dhe për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. Punëdhënësi i fundit është që paguan shpërblimin jubilar. Shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf ...”*, andaj me që në rastin konkret u vërtetua gjendja faktike siç është potencuar më lartë, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ta aprovoj si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe në bazë të dispozitave ligjore të cekura më lartë, duke pas parasysh faktin se paditëses i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës së saj lidhur me kërkesën e parashtruar, e njëjta si palë e legjitimuar ka të drejtë që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, sepse, sipas nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD) në mënyrë të qartë është paraparë se: *“Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, andaj, duke pas parasysh të cekurat më lartë, gjykata gjeti se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditëses, ku edhe vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditëses t’ia kompensoj shumën e kërkuar dhe të aprovuar nga gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të të paditurës se nuk janë ndarë fonde të mjaftueshme për ta kompensuar këtë kategori thekson se Kontrata Kolektive Sektoriale e datës 11.06.2018 të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 12.06.2018, e detyron dhe gjenë zbatim edhe për të paditurën duke u bazuar në nenin 17 lidhur me nenin 3 nën paragrafet e këtij neni 1.12.2 ku është dhënë edhe përkufizimi i statusit të

paditurës si institucion shëndetësor i nivelit dytësor të saj dhe se kontrata kolektive dhe nënshkrimi i saj nuk ka qëllim në vete por qëllimi është që të gjitha kategoritë e përcaktuara të Institucioneve Shëndetësore në Republikën e Kosovës dhe të gjithë të punësuarit në të, të marrin të drejta dhe detyrime konform dispozitave të kësaj kontrate.

Lidhur me kërkesën për kamatë ligjore, Gjykata vendosi duke u bazuar në Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve NR.04/L-077, në nenin 382.

Gjykata ka vendosur si në pikën **II** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që ta detyrojë të paditurën që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në lartësi prej 199€ edhe atë për pagesën e taksës gjyqësore shumë prej 20 €, për përpilimin e padis shumë prej 78 € si dhe për përfaqësim të një seancë shumë prej 101 €, duke u bazuar në nenin 452.1 dhe 463 të LPK-së, pasi që e paditura e ka humbur kontestin në këtë çështje.

Andaj, gjykata duke u bazuar në nenin 3, 22, 24, 31, 32, 49 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe në nenin 6 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë si dhe nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 65/2021, 18.05.2021

Gjyqtarja,
Kaltrinë HALITI

Udhëzim mbi Mjetin Juridik: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit, përmes kësaj Gjykate.

